# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-402352**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shpërthen vullkani në Indonezi, pezullohen 209 fluturime dhe bllokohen mijëra pasagjerë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/shperthen-vullkani-ne-indonezi-pezullohen-209-fluturime-dhe-bllokohen-mijer-i584305` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 13:32:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 14:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6088ce082a36d576e6e2fd2a3d95e5cfaabc3c3ef9f2cd3fbe0cc6d26666ad8b` |
| TEKSTI | `b9e4f35061af9d105e0022592d36cdb99f6ecb50c7ae7c3301d696d1f3f15520` |
| PAMJA | `8a460b7fa17e6efec05f2364cc0cfa3f893d01b60a5648228151f92a495b0187` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `537a488e651bfd332a7fc118990a479dc16878d0c3fc6229aeabf1d2c12d8ae7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b153b854c154dd4d6c3613e7c633ddb6afc042e1cebe995d4321c2de8150c895` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/537a488e651bfd332a7fc118990a479dc16878d0c3fc6229aeabf1d2c12d8ae7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Shpërthen vullkani në Indonezi, pezullohen 209 fluturime dhe bllokohen mijëra pasagjerë

TemA
6 Shtator 2026, 16:35Bota TEMA



Shpërthimi i vullkanit Anak Krakatau ka shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme në transportin ajror në Indonezi, duke detyruar autoritetet të pezullojnë përkohësisht operacionet në Aeroportin Ndërkombëtar  pranë Xhakartës.

Hiri vullkanik u zbulua në hapësirën ajrore pranë aeroportit gjatë orëve të para të së dielës, duke prekur më shumë se 22 mijë pasagjerë dhe 209 fluturime.

Ndikimi më i madh u regjistrua në linjat drejt dhe nga Singapori, ndërsa probleme pati edhe në fluturimet ndërkombëtare drejt Dohas, Sidneit dhe Kuala Lumpurit. Të paktën 16 fluturime të brendshme drejt Balit u anuluan gjithashtu.

Autoritetet indoneziane konfirmuan praninë dhe përhapjen e hirit vullkanik në zonën e aeroportit dhe zgjatën pezullimin e operacioneve, ndërsa po monitorojnë lëvizjen e resë së hirit për të vlerësuar rifillimin e fluturimeve.

Anak Krakatau nisi aktivitet të fuqishëm gjatë fundjavës. Vullkani shpërtheu disa herë, duke nxjerrë lavë, ndërsa u raportuan edhe aktivitet sizmik dhe zhurma të forta në zonat përreth. Dy shpërthime të tjera u regjistruan herët të dielën.

Hiri vullkanik ka shkaktuar probleme edhe për banorët në zonat pranë vullkanit. Ministria e Shëndetësisë u ka bërë thirrje qytetarëve të qëndrojnë brenda dhe të përdorin maska për t'u mbrojtur nga irritimet e syve, lëkurës dhe rrugëve të frymëmarrjes.

Disa shkolla kanë anuluar aktivitetet, pasi nxënës dhe banorë kanë raportuar irritim të syve. Ndërkohë, edhe peshkatarët kanë pezulluar daljet në det për shkak të pranisë së hirit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gjermani/ Senati refuzoi të paguante shantazhin 2 milionë euro, hakerët publikojnë 1.4 milionë dosje sekrete, mes tyre plane për sulme bërthamore]

15:15 Bota

Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut

14:45 Bota / 1 koment

["Rrezik për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç, SHBA duhet të ndryshojë strategji për ta fituar luftën](#)

14:35 Bota

["Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë](#)

13:35 Bota / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.